



Pranuar / Dorezuar Primijseno/Prodato Received/Delivery	27-12-2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTK	8491/2022		1/6



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 953/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga; Eshref Shabani, kryetar, Malsore Gashi - Bajraktari, dhe Arben Mehmeti, anëtar, si dhe Flakron Gashi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës me numër A. Nr. 953/2022, të datës 27.10.2022, së ankuses

kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshëm, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47, 48 paragrafi 1 dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativ dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.12.2022, mori këtë.

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar numër A. Nr. 953/2022, të datës 27.10.2022, së ankuses

II. MBETET në fuqi, Njoftimi i datës 12.10.2022, i Udhëheqëses së Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Ministrja e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë me datë 19.08.2022 përmes shkresës me nr.prot. 5960-01/02 është drejtuar me shkresë Ministrin të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike ka kërkuar iniciimin e procedurës së rekrutimit për Drejtor të Përgjithshëm në Agjencinë për Regjistrim të Bizneseve të Kosovës.

Ministria e Punëve të Brendshme, ka bërë njoftimin për hapjen e procedurës së konkurrimit përmes konkursit të datë 24.08.2022, me nr.ref. RN00009812, për pozitën "Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovës", në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa afati i aplikimit ka qenë nga data 24.09.2022, deri me datën 01.10.2022, ndërsa në konkurs kanë aplikuar gjithsejtë tetë (8), kandidatë.

Njësia përgjegjëse e rekrutimit, konform, nenit 8, të Rregullores (QRK) nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, ka bërë verifikimin paraprak të kandidateve dhe në listën e ngushtë të cilët i plotësojnë kushtet për aplikim ka përfshirë kandidatët të cilët i plotësoj kushtet, ndërsa kandidatët tjetër janë njoftuar se nuk i plotësojnë kushtet formale të konkursit dhe nuk kanë të drejtë të vazhdojnë me tutje.

Ankuesi është njoftuar me datën 11.10.2022, nga njësia përgjegjëse se pas shqyrtimit të aplikacionit tuaj, në aplikacion nuk keni bashkëngjitur diplomën e studimeve themelore, d.m.th sipas dëshmimeve të lëndës të dërguar nga MPB, ankuesi në kohën e aplikimit nuk ka bashkëngjitur diplomën e studimeve themelore por veç diplomën e masterit si dhe ankuesi në aplikim nuk ka ofruar dëshmi se ka 5 vite përvojë pune profesionale për këto arsye nuk mund të vazhdoj më tutje në procedurën e konkurrimit për pozitën „ Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovës“ në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë të zhvilluara nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Ankuesi i pakënaqur me njoftimin e datës 11.10.2022, të pranuar nga Njësia Përgjegjëse e Departamentit për Zhvillimin e rekrutimit dhe Inspektimit/ Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publik, të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me datë 27.10.2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me nr. të prot 6491/2022 me pretendimet ankimore, se ankuesi ka marrë konfirmim nga sistemi se aplikimi është kryer me sukses.

Ankuesi ka kërkuar sqarime nga DPZM po të njëjtit siç është përshkruar më lartë i janë përgjigj se nuk e ka të plotësuar aplikacionin sipas kushteve formale të parapara në konkursin e shpallur nga MPB të datës 24.09.2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 31.10.2022, me numër protokoll 6570/2022, ka dërguar përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa Ministria e Punëve të Brendshme me datë 29.11.2022, me numër protokoll 7465/2022, ka dërguar përgjigjen në ankesë tek Këshilli.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr.953/2022 e datës 27.10.2022, e parashtruar nga ankuesi me numër protokoll 6491/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimi i datës 25.10.2022; Letekonfirmimi i datës 01.09.2022; Certifikatë e datës 16.06.2022; Deklaratë e datës 01.10.2022; Diplomë me numër 459, e datës 30.05.2003; Diplomë e datës 06.05.2019; Vërtetim me numër protokoll 4116/22, e datës 14.09.2022; Konkursi i datës 24.09.2022; e- maili i datës 26.01.2022; Lista e aplikateve; e- maili i datës 17.10.2022; e- maili i datës 12.10.2022; e- maili i datës 11.10.2022; Njoftimi i datës 11.10.2022;

Lista e aplikateve; Vendimi nr. 04/73, i datës 30.04.2022, për Themelimin e Komisionit Shtetëror të Pranimit; Aplikacioni i Mehdi Pllashniku, me shkresat e bashkangjitura ;Diplomë Nr, 470, e datës 12.06.2013; Diplomë nr. 3032, e datës 31.08.2017; Vendim me numër 63882, i datës 14.11.2017; Diplomë Nr. 7060, e datës 21.10.1989; Certifikatë e datës 27-28 e muajit nëntor të vitit 2014; Certifikatë e datës 19-20 e muajit shtator të vitit 2014; Certifikatë e datës 10-11 e muajit shtator të vitit 2015 Letër motivuese ; Vërtetim i datës 18.10.2021, Certifikatë e datës 29.08.2022, e leshura nga Gjykata Themelore në Prishtinë; Vërtetim i datës 09.09.2022; Formuari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2019; Certifikate e datës 20.09.2014; certifikatë e datës 12-13, e muajit mars të vitit 2014; Formuari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021-2020; Kontrate e punësimit e datës 02.04.2013; Ndryshimi dhe plotësimi i akt emërimit i datës 07.05.2015; Përshkrimi i detyrave të punës; Akt Emërimi i datës 04.02.2013; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 01.10.2010; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 03.10.2007; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 02.10.2006; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 07.10.2004; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 14.10.2005; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 05.01.2004; Përshkrimi i detyrave të punës; Kontratë e punës e datës 13.02.2003; Librezë e punës e datës 20.09.1985; Aktvendimi me numer 53/91, e datës 01.04.1991; Certifikatë e datës 15.11.2013; certifikatë e datës 11-12, e muajit shtator të vitit 2015; certifikatë e datës 13-14, e muajit shkurt të vitit 2013; certifikatë e datës 14.09.2018; certifikatë e datës 16.08.2017; certifikatë e datës 03.11.2016; certifikatë e datës 07.12.2016; certifikatë e datës 16-17, e muajit qershor të vitit 2016; certifikatë e datës 12.06.2012; certifikatë e datës 23-24 , e muajit shtator vitit 2014; certifikatë e datës 06-09, e muajit tetor të vitit 2009; certifikatë e datës 14-24, e muajit nëntor të vitit 2012; certifikatë e muajit prill të vitit 2010; Certifikatën e datës 15-16, e muajit maj të vitit 2012; certifikatë e datës 22-23, e muajit shtator të vitit 2011; certifikatë e datës 15-16, e muajit maj të vitit 2012; certifikatë e datës 26-27, e muajit janar të vitit 2009; certifikatë e datës 18-19, e muajit mars të vitit 2013; Certifikatën e datës 13-26, e muajit nëntor të vitit 2008; certifikatë e datës 24.11.2020; Aplikacioni i Arber Muhaxheri, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë me numër 28/09 të datës 21.11.2009; Diplomë me numër 1336/20 të datës 10.09.2020; Letër Rekomandimi të datës 20.12.2014; Certifikatën e datës 20.07.2017; Vërtetim i datës 08.09.2022; Deklaratë e Garantuesit me numër 99701 të datës 20.12.2021; Akt Emërimi i datës 24.03.2016;Vërtetim i Marrëdhënies së punës 14.09.2022; Letër Rekomandimi 09.09.2022; Letër Reference e datës 15.09.2022; Letërnjoftim; Certifikatë e datës 30.08.2022, e leshura nga Gjykata Themelore në Prishtinë; Vërtetimi marrëdhënies së punës i datës 14.09.2022; përshkrimi mbi njohuritë aftësitë dhe cilësitë e përgjithshme të nevojshme të datës 14.01.2021;Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë; dëshmi nga trusti për përudhen nga data 01.08.2002, deri me datë 14.01.2016; Palyra e trustit; Certifikatë e datës 30.08.2022, cv, e Arbër Muhaxheri; Certifikatë e datës 17-20, e muajit korrik të vitit 2017; Aplikacioni i Lulzim Bajrami, me shkresat e bashkangjitura; Vërtetim i datës 17.01.2017; Vërtetim i datës 27.06.2022; Vërtetim me numër protokolli 150/20, i datës 16.01.2020; Akt Emërimi i datës 13.12.2019; Akt Emërimi i datës 19.12.2016; Vërtetim i datës 17.09.2019; Kontratë e Punës e datës 25.02.2021; Kontratë mbi vepër e datës 29.10.2018; letër motivimi i datës 30.09.2022; diplomë e datës 22.02.2019; Diplomë e datës 30.10.2012; Certifikatë e datës 30-08, e muajit tetor të vitit 2009; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 12.01.2009; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 19.01.2010; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 02.09.2009;Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 31.01.2011; Vërtetim i datës 01.06.2014; certifikatë e datës 18-19, e muajit shkurt të vitit 2014; certifikatë e datës 14-15, e muajit mars të vitit 2016; certifikatë e datës

21.11.2016; certifikatë e vitit 2017; certifikatë e datës 18-19, e muajit shkurt të vitit 2010; certifikatë e datës 23-24, e muajit maj të vitit 2011; certifikatë e datës 12-13, e muajit maj të vitit 2011; certifikatë e datës 15-16, e muajit mars të vitit 2012; certifikatë e datës 30-7, e muajit tetor të vitit 2009; Aplikacioni i Kushtrim Brahimaj, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 16.08.2018, me numër protokoll 1668; Diplomë e datës 28.06.2013; Certifikatë e datës 17.05.2022; Vërtetimi datës 30.05.2022; Vërtetimi datës 17.01.2022; Reference e datës 25.02.2008; Vërtetim i datës 09.07.2013; Vërtetim i datës 03.07.2020; Vërtetim i datës 11.10.2021; Diplomë e datës 07.06.2003; Certifikatë e datës 16-17, e muajit mars të viti 2022; Certifikatë e datës 20-21, e muajit shtator të viti 2018; Aplikacioni i Astrit Zherka, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 12.05.2017, me numër protokoll 7835; dëshmi nga pro credit bankë; Letër konfirmim; Aplikacioni i me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 06.05.2019, me numër 182; Certifikatë e datës 20.12.2005; Letër konfirmim i datës 01.09.2022; Vërtetim i datës 14.09.2022; Vërtetimi i datës 17.07.2009; Vërtetimi i datës 26.08.2009; Aplikacioni i Nexhmie Selimi, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 07.12.2016, me numër protokoll 871/16; Certifikatë e datës 07-07, e muajit prill të vitit 2021; Vërtetimi i datës 21.09.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 01.01.2009; Vendim i datës 05.06.2018; Aplikacioni i Besnik Demiri, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 14.07.2006, me numër 446; dëshmi nga trusti për periudhën 14.07.2004, deri me datë 27.09.2022; Përgjigje në ankesë e datës 29.11.2022, me numër protokoll 7465/2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pa bazuar sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit të paraqitura në ankesë lidhur me zhvillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën „Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovës, në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, të publikuara nga Ministria e Punëve të Brendshme, i cili pretendon se ma rastin e aplikimit ka bashkëngjitur të gjitha dokumentet formale të kërkuara nga MPB me rastin e shpalljes së konkursit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave konstaton së në konkursin e shpallur të datës 24.08.2022, për pozitën „Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovës” në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë të zhvilluara nga Ministria e Punëve të Brendshme, kriteret e përgjithshme formale të konkursit kanë qenë:

- **Diplomë të studimeve Universitare, me të paktën 240 kredi/ECTS-së apo ekuivalente me to. Diplome universitare në menaxhment, Administrim Biznesi, biznes ndërkombëtar, ekonomik, ose juridik.**
- **Se paku (8) vite përvoje pune profesionale, duke përfshirë së paku pesë (5) vite përvojë pune në pozita drejtues.**

Bazuar në shkresat e lëndës konstatohet se ankuesi në bazë të aplikacionit të parashtruar tek Ministria e Punëve të Brendshme, ka bashkëngjitur diplomën Nr. 182, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës „Hasan Prishtina”, të MASTERIT të Fakulteti Juridik -

drejtimi Penal, i cili ka diplomuar me datë 22.06.2010, me përvojë punë si në vijim; në bazë të vërtetimi të datës 14.09.2022, nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, nga data 01.12.2000, deri me datën 30.06.2022, ka mbajtur pozitën „ Udhëheqës i Sektorit për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun“, Vërtetimi të datës 17.07.2009, të Lëshuar nga Oda e Avokateve të Punës, nga data 27.05.2022, deri me datën 27.05.2003, në pozitën „ Praktikant“, vërtetimi i datës 26.08.2009, i lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administrata Publike, nga data 01.08.2033, deri me datë 31.12.2005, në pozitën „ Zhvillues i Programit për Legjislacion“, në bazë të shkresë së lëshuar nga UNMIK, nga janari i viti 2006, deri në muajin qershor të vitit 2008, e në pozitën „ Zyrtar“, Si dhe në bazë të shkresës së datës 05.10.2009, e lëshuar nga Drejtori i Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Kosovare të Privatizimit, në pozitën „ Zyrtar për Zhvillim të Ndërmarrjeve( Jurist), prandaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se ankuesi nuk i ka plotësuar kushtin e përgjithshëm të formale dhe të veçantë “ Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për Regjistrimit e Bizneseve në Kosovës”, nga Ministria e Punëve të Brendshme, andaj kolegji konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit nuk janë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji, për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar së për pozitën Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për Regjistrimit e Bizneseve në Kosovës”, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, kanë aplikuar gjithsejtë tetë (8), kandidatë, ndërsa në listën e ngushtë për pozitën janë përfshirë katër (4) kandidate, kolegji pasi ka analizuar edhe listën e ngushtë të gjithë kandidateve që janë përfshirë në listën e ngushtë nga Komisioni Shtetëror i Pranimit për pozitën e larta drejtues, për pozitën „Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për Regjistrimit e Bizneseve në Kosovës”, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ka analizuar listën e ngushtë dhe dosjen e të gjithë aplikantëve që janë përfshirë në listën e ngushtë, dhe pas analizimit të dosjeve të kandidateve kolegji ka konstatuar së të gjithë aplikantët i kanë plotësuar kushtet e përgjithshme formale, dhe në këtë rast Komisioni Shtetëror i Pranimit për pozitën e larta drejtues, ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, sa i përket, përgatitjes së listës së ngushtë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar së Udhëheqësja e Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, në Ministrinë e Punëve të Brendshme me 10.10.2020, për mes e- mailit, ankuesit i ka refuzuar aplikacionin, dhe në këtë rast Udhëheqja e Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit ka vepruar në pajtim me nenin 8, paragrafi 5,6 dhe 7, të Rregullores (QRK) nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, ku përcaktohet së; 5. Kandidatët të cilët nuk i plotësojnë kushtet për aplikim nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin. Njoftimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim arsyetohet duke përfshirë të gjitha kriteret dhe/ose dëshmitë e papërmbyshura dhe u dërgohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se tre (3) ditë kalendarike nga data e publikimit të rezultateve. 6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual, në pajtim me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin kërkesë me shkrim për sqarime shtesë ose të paraqiten tek Njësia Përgjegjëse për t’u njohur me arsyet e detajuara për mos kualifikim për konkurrim të mëtejshëm. 7. Njësia Përgjegjëse, brenda afatit prej pesë (5) ditëve kalendarike duhet të përgjigjet me shkrim në kërkesën e kandidatit si në paragrafin 6 të këtij neni, duke dhënë arsyet e detajuara për mos kualifikim për konkurrim të mëtejshëm.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Udhëheqësja e Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, me 12.10.2020, për mes e- mailit, ankuesit i ka refuzuar aplikacionin e ankuesit, me arsyetimin se nuk i plotëson kushtet e përgjithshme, për tu përfshirë në listën e ngushtë, ka vepruar , në pajtim me nenin 8, paragrafi 1,2,3, të Rregullores (QRK) nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, ku përcaktohet së; **1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim.2. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikacionit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak. 3. Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që i plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë konkurrimin në fazën e vlerësimit profesional.**

Ndërlidhur me këtë Kolegji konstaton se ankuesi, nuk është përfshirë, në listën e Ngushtë për pozitën „ Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për Regjistrimit e Bizneseve në Kosovës”, Ministria e Industrisë, Ndërmarrsisë dhe Tregtisë të zhvilluara nga Ministria e Punëve të Brendshme, dhe se Udhëheqësja e Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, me 12.10.2020, për mes e- mailit, ankuesit i ka refuzuar aplikacionin , me arsyetimin nuk i plotësoni kushtet e përgjithshëm formale dhe të veçanta lidhur me konkursin për pozitën „ Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për Regjistrimit e Bizneseve në Kosovës”, Ministria e Industrisë, Ndërmarrsisë dhe Tregtisë të zhvilluara nga Ministria e Punëve të Brendshme, kolegji konstaton se Ministria e Punëve të Brendshme në rastin e refuzimit e aplikacionit të ankuesit Fatmir Geca, ka vërtetuar drejte gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me numër A nr. 953/2022**

**Flakron GASHI**

Procesmbajtës

**Eshref SHABANI**

Kryetar i Kolegjit

*Vendimi i dorëzohet:*

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme
- Departamentin për Menaxhimin e Zyrtareve Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Arkiviot të KPMSHCK-së,